

ZBATIMI NE PRAKTIKEN AUDITUESE TE KLSH-SE TE STANDARTEVE NDERKOMBETARE ISSAI SI SHENJE E RRRITJES SE PROFESIONALIZMIT NË KLSH

L.Nano A.Zace

Qasja e INTOSAIT ndaj Standarteve ISSAI

Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit, INTOSAI kërkon që SAI-t anëtare :

- *Të përdorin ISSAI-t si kuadër referues për auditimin në sektorin publik;*
- *Të vlerësojnë udhëzuesit dhe performancën e auditimeve të tyre kundrejt ISSAI-ve;*
- *Të implementojnë ISSAI-t në pajtueshmëri me mandatin dhe legjislacionin e tyre kombëtar;*

Standartet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI) vendosin parakushtet dhe parimet themelore për funksionimin e duhur dhe performancën profesionale të Institucioneve Supreme të Auditimit .

Vizioni i KLSH-së për implementimin e Standarteve ISSAI

KLSH dhe audituesit në kryerjen e auditimit në sektorin publik udhëhiqen nga ISSAI-t dhe qasja e INTOSAI-t për auditimin e sektorit publik.

KLSH konsideron se njohja, implementimi i Standarteve Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) përbëjnë një objektiv parësor në funksion të rritjes dhe forcimit të profesionalizmit performancës dhe kredibilitetit institucional.

Misioni i KLSH-së për implementimin e Standarteve ISSAI

KLSH synon që të ndërtojë dhe zhvillojë një kuadër të plotë dhe gjithpërfshirës të standarteve të punës audituese, të tillë që të reflektojë pajtueshmëri me ISSAI-t, të aftësojë dhe pajisë audituesit me njohuritë dhe dijet e nevojshme për kryejn e auditimeve cilësore, në përputhje me Standartet dhe Praktikat më të mira Ndërkombëtare të Auditimit Publik.

Vizioni dhe Misioni i KLSH-së për Implementimin e ISSAI-ve janë derivate të Misionit dhe Vizionit institucional.

Kongresi XX i INTOSAI prezantoi një moment historik në forcimin e profesionit të auditimit në sektorin publik *pasi adoptoi një set gjithpërfshirës të Standarteve Ndërkombëtare për Institucionet Supreme të Auditimit (*

ISSAI) dhe që mbulojnë disiplinat kryesore të auditimit financiar, të performancës dhe përputhshmërisë.

Në përmbushje të misionit kushtetues, dhe plotësisht i angazhuar në përjasjen e tij ndaj standardeve profesionale të INTOSAI-t në vitin 2013 Kontrolli i Lartë i Shtetit nënshkroi Marrëveshjen e Angazhimit bazuar në të cilën të tre palët KLSH, IDI dhe EUROSAI angazhohen për implementimin e ISSAI-ve, nëpërmjet hartimit dhe miratimit të Strategjisë për Implementimin e ISSAI-ve.

Implementimi i standardeve ndërkombëtare të auditimit dhe qasja në auditim sipas praktikave më të mira të institucioneve homologe ishte një nga objektivat kryesore të Strategjisë së Zhvillimit Institucional 2013-2017 dhe **baza themelore** për Strategjinë e Implementimit të ISSAI-ve konsideruar ky një proces i domosdoshëm i cili synon të transformojë veprimtarinë e KLSH në nivelin e institucioneve homologe të vendeve të BE duke rritur kontributin në procesin e integritetit të vendit tonë në BE.

Duke thelluar më tej angazhimin në implemetimin e ISSAI-ve si pjesë aktive e INTOSAI-t, KLSH ka përcaktuar hapat konkretë në këtë drejtim, të cilat pasqyrohen në *Strategjinë e Zhvillimit të KLSH, 2013- 2017 (e ripunuar)*.

Objektivi Strategjik 1. përfshin¹: Zhvillimin e kapaciteteve institucionale. Amendimi i bazës ligjore dhe rregullatore të KLSH-së në përputhje me ISSAI dhe praktikat e mira evropiane.

Referuar objektivit strategjik për Impementimin e ISSAI-ve u kryen amendimet në strategjinë e zhvillimit të KLSH për periudhën 2013 – 2017 (te ripunuar) për implementimin e standardeve ISSAI, për periudhën 2015 – 2016 gjë e cila do të krijojë kushtet për fillimin e punes per ndërtimin e **Standardeve Kombëtare të Auditimit** sipas ISSAI, në vitin 2017.

Strategjia e implementimit të standardeve ndërkombëtare të auditimit ofron kornizën e përgjithshme të transformimit të veprimtarisë së KLSH në fushën e auditimit të përputhshmërisë, financiar dhe performancës dhe IT sipas standardeve përkatës ISSAI është pjese integrale e Strategjisë së Zhvillimit të KLSH 2013-2017 (e ripunuar).

Miratimi i Ligjit nr 154/2014, datë 27.11.2014 “ Për Organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i mbështetur dhe vlerësuar me nota të larta pozitiviteti nga Organizmat e BE-së, dhe ekspertët ndërkombëtarë, si një ligj plotësisht në pajtueshmëri me standartet e INTOSAI-t, shënoi një

¹ Plani Zhvillimit Strategjik te KLSH 2013-2017, ëëë. klsh.org.al, botim 2013

moment kthese drejt progresit për institucionin e KLSH-së për implementimin e ISSAI-ve.

Implementimi i ISSAI-ve afekton procesin e menaxhimit të ndryshimit, që prek disa fusha të rëndësishme për aktivitetin e KLSH dhe që janë domethënëse jo vetëm për ekzistencën por dhe për mbarëvajtjen dhe punën e institucionit sipas parimeve të vendosura dhe kjo përfshin:

- Kapacitetin institucional, si mandatin dhe ambjentin ligjor në të cilin KLSH operon;
- Kapacitetin organizativ, si sistemet, proceset dhe procedurat si dhe burimet që nevojiten për implementimin e ISSAI-ve
- Kapacitetin profesional në të cilin përfshihen niveli drejtues ashtu dhe stafi auditues.

Iniciativa dhe përkushtimi i KLSH për të siguruar që veprimtaria audituese të kryhet në pajtueshmëri me ISSAI-t, në vijimësi ka qenë në fokus të veprimtarisë institucionale në këto vite.

Strategjia e implementimit të standardeve ndërkombëtare të auditimit do të ofroi kornizën e përgjithshme të transformimit të veprimtarisë së KLSH në fushën e auditimit të përputhshmërisë, financiar dhe performancës sipas standardeve përkatës ISSAI dhe është pjesë e Strategjisë së Zhvillimit të KLSH 2013-2017 (e ripunuar).

Në funksion të implementimit të ISSAI, KLSH përcaktoi objektivat e mëposhtme .

- 1. Krijimi i kuadrit të përshtatshëm metodologjik dhe udhëzuesish profesionalë botimesh të ISSAI-ve për implementimin praktik të ISSAI-ve për Auditimin Financiar, Auditimin e Përputhshmërisë dhe Auditimin e Performancës;***
- 2. Ngritje dhe zhvillim i kapaciteteve audituese , aftësimi dhe thellimi i njohurive për të siguruar implementimin e ISSAI-ve në përshtatje me kuadrin rregullator***
- 3. Kryerja e veprimtarisë audituese të KLSH në pajtueshmëri me Standartet Ndërkombëtare të INTOSAI-t dhe krijimi i bazës për zhvillimin e standarteve kombëtare të auditimit publik.***

Në zbatim të këtyre objektivave KLSH veprimtaria e KLSH-së është fokusuar në drejtimet e mëposhtme:

-Botimi i Standarteve të INTOSAI-t ” qe në Dhjetor 2012 i hapi rrugën një tërësie botimesh të Udhëzuesve të INTOSAI- ISSAI të niveleve të tjera të cilët do të bëheshin më vonë baza e njohjes me kërkesat e këtyre standarteve nga audituesit e KLSH ashtu dhe palëve të tjera të interesuara.

Botimi i viti 2012 “Standartet e Auditimit INTOSAI“ *është ndjekur nga botime të tjerë të ISSAI-ve, që përcaktohen si tepër të rëndësishëm dhe vendimtar për të mbështetur rrugën e ndryshimit që KLSH ka ndërmarrëne keto vite .*

Për më tepër, përkthimi dhe botimi në shqip i Standarteve të Zyrës së Auditimit të Shteteve të Bashkuara (GAO) (ne vitin 2015) përbëjnë një burim tepër të vlefshëm për dijet mbi auditimin , specifika të kryerjes së auditimeve dhe do të shërbejnë gjithashtu si udhëzues dhe njohuri shtesë për audituesit e KLSH dhe do të përbëjnë një bazë të mirë për përgatitjen e Standarteve Kombëtare të Auditimit përgjatë vitit 2017.

-Përgatitja dhe Hartimi i Manualeve të Auditimit Financiar të Përputhshmërisë dhe të Performancës. Të tre Manualët janë subjekt i rishikimit gjatë periudhës së implementimit të Projektit IPA 2015-2017.

-Hartimi dhe implementimi i Manualeve të auditimit financiar dhe të përputhshmërisë. Kryerja e auditimeve pilot përgjatë vitit 2016.

Në kuadër të zbatimit të kërkesave të Strategjisë së Menaxhimit institucional 2013-2017 (të ripunuar), të Strategjisë së Implementimit të ISSAIve dhe të aktiviteteve të parashikuara në Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020 Shtylla 6, si dhe në përmbushje të kërkesave të Programit Buxhetor Trigger Matrix, KLSH hartoi Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë dhe Manualin e Auditimit Financiar. Manualët u miratuan nga Kryetari i KLSH-së me 31.12.2015 dhe iu dërguan Delegacionit European dhe SIGMA-s për dhënie mendimi dhe opinionin në funksion të përmirësimit të tyre.

Ne perfundim te procesit te rishqyrtimi nga SIGMA kjo e fundit adresoi rekomandimet ne te cilen theksohej që: *Përmirësime të mëtejshme duhet të vijojnë bazuar në mësimet e nxjerra nga auditimet pilot për të suportuar audituesit në zbatimin e Standardeve të Auditimit INTOSAI.*

Po kështu në përmbushje te detyrimeve KLSH KLSH në fund të vitit 2016, përmbushi kryerjen e 13 auditimeve pilot konform detyrimeve të përcaktuara

nga Matrica e zbatimit të programit buxhetor të Strategjisë së Meaxhimit të Financave publike duke reflktuar ne Manualet te gjitha problematikat e rezultuara nga procesi i testimit.

-Përmirësim i Udhëzimit të Zbatimit të Rekomandimeve. Në udhëzimin nr 1 datë 04.11.2016 “Për procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës, në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, u reflektuan përmirësimet që ka pasuar kuadri rregullator dhe funksional i KLSH-së, përmirësimi i metodologjisë audituese dhe nga implementimi i standardeve ISSAI. Në këtë udhëzim u reflektua gjithashtu eksperiencia e akumuluar nga KLSH, si dhe konkluzione të bashkëpunimit me ekspertë të projektit IPA, SAI-t homologe dhe angazhimi në veprimtari ndërkombëtare të INTOSAI-t, ECA-s dhe SIGMA-s. Kornizimi i procesit të ndjekjes së rekomandimeve i shërben jo vetëm audituesit të KLSH-së, por edhe subjektit të audituar, i cili orientohet në veprimtarinë tij për të zbatuar rekomandimet e KLSH-së.

-Përmirësim i Udhëzimit mbi rritjen e kapaciteteve audituese dhe të cilësisë në auditim. Udhëzimi numër 2 datë 30.12.2016 ka ardhur si një përmirësim i udhëzimit të vitit 2012 për të promovuar dhe mbështetur zhvillimit profesional dhe individual të audituesve të KLSH-së. Qëllimi i këtij udhëzuesi është forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve të burimeve njerëzore të institucionit të KLSH-së, duke orientuar zhvillimin e vazhdueshëm profesional të audituesit. Udhëzimi është zhvilluar në funksion të promovimit të zhvillimit profesional. Si i tillë më shumë se sa një Udhëzim, që synon të promovojë **zhvillimin profesional i audituesve të KLSH-së**, ne nje linje me standardet e INTOSAI .

- *Zhvillimi i metodologjisë së planifikimit vjetor në auditim* duke reflektuar kërkesat e ISSAI-ve përkatës për këtë qëllim, proces ky i cili u realizua nepermjet eksperteve te IPA-s pergjate vitit 2016 per planin e veprimtarise audituese te vitit 2017.

Mund te konfoimohet që i gjithë procesi i implementimit të standarteve profesionale te auditimit eshte shoqëruar me trajnime intensive 1. Trajnime në standarde ISSAI,

2. Trajnime në Manualet e Auditimit,

3. Trajnime rregullore të procedurave të auditimit etj,

4. Trajnime për rregullore e brendshme, strategji zhvillimi etj .

Në përfundim theksojmë që Implementimi i Standarteve ISSAI është një proces dinamik pasi dhe vete zhvillimi i standarteve profesionale të auditimit është i tillë dhe vete Institucionet Supreme të Auditimit kudo në bote po përballen me Standarte të reja kjo në përgjigje dhe reflektim të shndrimeve në nivel global. E përveç kësaj këndvështrimi implementimi i standarteve profesionale do të vijojë të jetë një prej prioriteteve dhe fokusi kryesor i menaxhimit institucional